

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “B Creative” shpk,

Në Tiranë, sot më datë 01.09.2021, une e poshtëshënuara: Vjola Baze Blushi lindur ne Tirane me date 14 Maj 1987,identifikuar me karte identiteti me numer I75514079B , me cilësinë e “ortakut themelues”deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar;

“B Creative” shpk.

Neni 1 Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin**“B Creative” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3 Selia

Shoqëria **“B Creative” shpk** e ka seline në adresë: Rruga Peti Nr 153,Zona Kadastrale 3292,Numër pasurie 153/116+3N2 Kati I-re,Farke ,Tirane” dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqërine **“B Creative” shpk** është: Shërbime Marketingu brenda dhe jashtë Shqipërise.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Vjola Blushi


Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cila zotërohet si më poshtë: Vjola Baze Blushi lindur në Tiranë me date 14 Maj 1987, identifikuar me karte identiteti me numer I75514079B, zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë, pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

Vjola Blushi
Baze

- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë **"B Creative" shpk** është: Vjola Baze Blushi lindur në Tiranë me date 14 Maj 1987, identifikuar me kartë identiteti me numer I75514079B
Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit të tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 01.09.2021.

Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11 Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike. Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën për nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare **"B Creative" shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKU THEMELUES

Vjola Blushi

Vjola Blushi


Tiranë, më datë 01.09.2021

Vjola Blushi
